



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2018 – Numri: 187

Tiranë – E premte, 28 dhjetor 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 93/2018 datë 3.12.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar..... 14105
Ligj nr. 95/2018 datë 3.12.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar..... 14106
Ligj nr. 96/2018 datë 3.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14112
Ligj nr. 97/2018 datë 3.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14113
Ligj nr. 98/2018 datë 3.12.2018	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14118
Vendim i Kuvendit nr. 127/2018 datë 20.12.2018	Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institutit të statistikave (INSTAT)..... 14125
Vendim i Kuvendit nr. 128/2018 datë 20.12.2018	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”. 14132
Vendim i Kuvendit nr. 134/2018 datë 20.12.2018	Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik..... 14134
Vendim i Kuvendit nr. 137/2018 datë 21.12.2018	Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 14143



LIGJ
Nr. 93/2018

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008,
“PËR TAKSAT KOMBËTARE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 3, “Llojet e taksave kombëtare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 8 dhe 8/1 riformulohen si më poshtë:

“8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi.”.

8/1. Materiale/artikuj plastikë konsiderohen mallrat e importuara sipas kapitullit 39 të NKM-së.”.

2. Pas pikës 8/1 shtohet pika 8/2 me këtë përmbajtje:

“8/2. Ambalazh plastik/qelqi është çdo material paketues, që shërben për paketimin e produkteve, i cili mund ta mbulojë tërësisht ose pjesërisht atë, me qëllim mbrojtjen e produktit nga ndotja, infeksionet, nga ndikimet që ulin cilësinë dhe/ose vlerën e tij dhe që e bëjnë të përshtatshëm për transport, tregtim e përdorim. Një ambalazh mund të përmbajë disa njësi ose tipa ambalazhesh.”.

Neni 2

Në nenin 4, “Niveli i taksave kombëtare”, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

1. Në pikën 4, në paragrafin e parë dhe të tretë, fjalët “në masën sa 1/2 e normës së rentës” zëvendësohen me fjalët “në masën sa 3/7 e normës së rentës për vitin 2019, 3/8 e normës së rentës për vitin 2020 dhe 1/3 e normës së rentës për vitin 2021 e në vijim”.

2. Në fund të pikës 6 shtohet fjalia me këtë përmbajtje

“Kjo taksë nuk paguhet për sasitë e benzinës dhe të gazoilit që eksportohen.”.

3. Pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Taksa e materialeve/artikujve plastikë dhe e ambalazheve plastike të importuara në kapitullin 39, të NKM-së, është 35 lekë/kg, me përjashtim të lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së. Përveç kapitullit 39, kjo taksë zbatohet edhe kur materiali plastik zë, të paktën, 51 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera të importuara, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.1 Taksa e lëndëve të para në forma primare, të importuara në krerët 3901 deri në 3914, të NKM-së, dhe që përdoret për prodhimin në vend të produkteve të plastikës është 25 lekë/kg.

8.2 Taksa e ambalazheve prej qelqi është 5 lekë/kg dhe zbatohet për ambalazhet prej qelqi të importuara e të prodhuara në vend. Taksa zbatohet për të gjithë artikujt prej qelqi, sipas kreut 7010 të NKM-së, në rast se ambalazhi importohet veçmas, si dhe kur materiali i qelqit zë, të paktën, 80 për qind të masës së përgjithshme të ambalazhit që ambalazhon produkte të tjera, të klasifikuara në kapitujt, krerët, nënkrerët dhe kodet e tjera tarifore të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave.

8.3 Në rastin e importit, taksa e materialeve/artikujve plastikë, lëndëve të para në forma primare për prodhimin e materialeve plastike, si dhe e ambalazheve prej plastike/qelqi llogaritet dhe mbledhet nga administrata doganore në momentin e importit.

8.4 Në rastin e prodhimit brenda vendit, taksa e ambalazheve prej qelqi mbledhet nga administrata tatimore, sipas afateve dhe procedurave të deklarimit në këtë ligj. Administrata tatimore monitoron dhe kontrollon lëndët e para që përdoren për prodhimin e ambalazheve të qelqit, si dhe lëndët e para në forma primare, të importuara, me qëllim prodhimin e materialeve dhe ambalazheve plastike brenda vendit.”.

8.5 Për ambalazhet plastike/qelqi, të cilat eksportohen dhe për të cilat taksa është paguar



në momentin e importit/prodhimit të tyre, administrata doganore rimbursion shumën e taksës së paguar. Rimbursimi bëhet sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave.”.

Neni 3

Në nenin 5, “Agjentët e taksave”, shkronja “ë” riformulohet si më poshtë:

“ë) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe taksën e ambalazheve prej plastike/qelqi ngarkohen:

i) administrata doganore, në rastet e importit të materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi;

ii) administrata tatimore, në rastet e prodhimit brenda vendit të ambalazheve prej qelqi.”.

Neni 4

Në nenin 8, “Komisionet që përfitojnë agjentët e taksave”, pika 2, shkronja “e” riformulohet si më poshtë:

“e) për taksën e materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, 0 për qind;”.

Neni 5

Në nenin 9 “Përjashtimet nga pagimi i taksave kombëtare”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1/1, pas fjalëve “Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, shtohen fjalët “ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjala e parë riformulohet si më poshtë:

“4. Përjashtohen nga pagimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë dhe ambalazheve prej plastike/qelqi, sipas nenit 4”.

b) Në shkronjën “ç”, nënpikat “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “vi” dhe “vii” hiqen.

3. Në pikën 7, shkronja “ç”, pas fjalëve “Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara”, shtohen fjalët “ose Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit”.

Neni 6

Në shtojcën nr. 2, “Renta minerare sipas klasifikimit”, në grupin I, “Mineralet metalike”,
Faqe|14106

në pikën 4, “Mineralet e kromit për eksport”, përqindja e rentës minerare bëhet 7 % duke filluar nga data 1 janar 2019, 8 % duke filluar nga data 1 janar 2020, dhe 9 % duke filluar nga data 1 janar 2021 dhe në vijim.

Neni 7

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.12.2018

LIGJ
Nr. 95/2018

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 9632, DATË 30.10.2006,
“PËR SISTEMIN E TAKSAVE
VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 e 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, “Përkufizime”, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. “Niveli tregues i taksës” janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij ligji, si dhe në anekset bashkëlidhur ligjit.”.

Neni 2

Në nenin 5, “Rregulla të përbashkëta për taksat vendore”, në fjalinë e parë, fjala “këshilli i bashkisë:” zëvendësohet me fjalët “bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:”.



Neni 3

Në nenin 21, “Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2.1, fjalët “, në anekset 2 dhe 2.1,” zëvendësohen me fjalët “, në anekset 1 dhe 2.”.

2. Në pikën 3, fjalët “të parashikuar në aneksin 2,” zëvendësohen me fjalët “të parashikuar në aneksin 1,”.

Neni 4

Në nenin 22, “Taksa mbi ndërtesat”, pika 6, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ë” ndryshohet si më poshtë:

“ë) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë vetëm pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;”.

2. Në shkronjën “g”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse”.

Neni 5

Në nenin 22/4, “Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) vlerëson vlerën e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat me metodat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimin për taksën e pasurisë ndërtesë.”.

Neni 6

Në nenin 23, “Taksa mbi tokën bujqësore”, pikat 1 e 2, fjalët “në aneksin 2,” zëvendësohen me fjalët “në aneksin 1,”.

Neni 7

Në nenin 23/1, “Taksa mbi truallin”, pikat 1 e 2, fjalët “në aneksin 2.1,” zëvendësohen me fjalët “në aneksin 2,”.

Neni 8

Në nenin 24, “Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave”, në fjalinë e tretë, fjala “bashkitë” zëvendësohet me fjalët

“bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë”.

Neni 9

Në nenin 27, “Taksa e ndikimit në infrastrukturë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1, në fjalinë e parë, pas fjalëve “e investimit të ri që kërkohet të kryhet” shtohen fjalët “, sipas preventivit,”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri në 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror.

Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t’u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncesionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit.

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njërive të tregtimit dhe shërbimit. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rastin e ndërtimeve, të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe:

a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë, të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët, të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 për qind e saj;

b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për



qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;

c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi;

d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 deri në 3 për qind e vlerës së investimit. Këshilli bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi.”.

Neni 10

Neni 32, “Taksa të tjera”, ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 32

Taksa e tabelës

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjitha subjektet, të cilat vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendndodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendndodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në:

a) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logoja dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

b) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të

publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

c) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose joballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si: tarraca, lozha, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, për të tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

ç) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore. Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga shkronja të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si: mur, fasadë e jashtme e çdo lloji, shtyllë, kolonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë e shkruar, e stampuar apo e pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zënë të gjitha shkronjat, figurat, logot dhe simbolet që formojnë tabelën.

Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe shkronja, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produkteve apo shërbimeve që furnizohen nga vetë njësia, ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori table. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi.



Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabele identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabele.

5. Nivelet e taksës së tabelës, sipas kategorizimeve të përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, jepen në aneksin 7, që i bashkëlidhet këtij ligji.

6. Këshilli bashkiak është autoriteti, i cili vendos nivelin e bazës së taksës për çdo kategori të tabelës të dhënë në aneksin 7, që i bashkëlidhet këtij ligji, dhe miraton procedurën e mbledhjes së kësaj takse.”

Neni 11

Neni 32/1, “Taksa e tabelës”, shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 35, “Tarifat vendore dhe administrimi i tyre”, në fund të pikës 4, shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Për rrjetet kabllore telefonike, ndërlidhëse apo të shërbimit informatik, tarifat vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore, si: tubacione, kanale etj.,

të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore. Të ardhurat e siguruar prej tyre shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim.”.

Neni 13

Kudo në ligj, ku përdoren fjalët “organet e qeverisjes vendore ” zëvendësohen me fjalët “njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Neni 14

Aneksi 4, “Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit rrugor”, aneksi 5, “Tabela e taksimit të biznesit të vogël”, dhe aneksi 6, “Niveli tregues i taksës së zënies së hapësirës publike”, shfuqizohen.

Neni 15

Anekset 2, 2.1, 3 dhe 8 zëvendësohen përkatësisht me anekset 1, 2, 3 dhe 8, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2018



Aneksi I

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS VENDORE MBI PASURINË E PALUAJTSHME TOKË

KLASIFIKIMI SIPAS BASHKIVË

KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
Durrës	Berat	Devoll	Bulqizë
Shijak	Poliçan	Dibër	Gramsh
Fier	Ura Vajgurore	Gjirokastër	Has
Patos	Delvinë	Dropull	Kolonjë
Roskovec	Elbasan	Libohovë	Kukës
Kavajë	Belsh	Librazhd	Fushë Arrëz
Rrogozhinë	Cërrik	Përrenjas	Malësi e Madhe
Krujë	Korçë	Mallakastër	Mirditë
Lezhë	Maliq	Mat	Pukë
Lushnjë	Pustec	Klos	Tropojë
Divjakë	Kuçovë	Përmet	
Sarandë	Kurbin	Këlcyrë	
Konispol	Peqin	Pogradec	
Finiq	Shkodër	Skrapar	
Tiranë	Vau i Dejës	Tepelenë	
Vorë		Memaliaj	
Kamëz			
Vlorë			
Himarë			
Selenicë			

KLASIFIKIMI SIPAS KATEGORISË SË TOKËS BUJQËSORE

KATEGORIA E TOKËS	VLERA E TAKSËS NË LEKË PËR HEKTARË NË VIT (lekë/ha/vit)			
	KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
I	5,600	4,200	2,800	1,400
II	4,900	3,500	2,100	1,200
III	4,200	2,800	1,400	1,100
IV	3,600	2,300	1,350	1,000
V	3,000	1,900	1,250	900
VI	2,400	1,600	1,200	800
VII - X	1,800	1,400	1,100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë



Aneksi 2

**KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS VENDORE MBI PASURINË E
PALUAJTSHME TRUALL (JO HAPËSIRË PUBLIKE)**

	KATEGORITË E BASHKIVE			
	I	II	III	IV
	TIRANË DURRËS KAVAJË KRUJË LEZHË LUSHNJË FIER VLORE SARANDË	SHKODËR ELBASAN BERAT KORÇË DELVINË KURBIN PEQIN KUÇOVË	GJIROKASTËR PËRMET POGRADEC LIBRAZHD DIBËR MAT SKRAPAR MALLAKASTËR DEVOLL TEPELENË	TË GJITHË BASHKITË E TJERA
NIVELI I TAKSËS SË TRUALLIT NË LEKË PËR METËR KATROR NË VIT				
Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët	0,56 lekë/m ² /vit	0,42 lekë/m ² /vit	0,28 lekë/m ² /vit	0,14 lekë/m ² /vit
Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi	20 lekë/m ² /vit	18 lekë/m ² /vit	15 lekë/m ² /vit	12 lekë/m ² /vit

Aneksi 3

NIVELET E TAKSËS VENDORE PËR KALIMIN E TË DREJTËS SË PRONËSISË MBI NDËRTESAT

Lekë për m²

KATEGORITË E NDËRTESAVE	KATEGORITË E BASHKIVE		
	I	II	III
	TIRANË DURRËS	VLORE FIER SARANDË POGRADEC KORÇË ELBASAN BERAT LUSHNJË GJIROKASTËR SHKODËR KAVAJË LEZHË	BASHKITË E TJERA Dhe të gjitha njësitë administrative jashtë qytetit përkatës për bashkitë e kategorive I, II dhe III, të cilat ju bashkuan njësitë të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014
I. Ndërtesa banimi	1 000	300	100
II. Ndërtesa për tregti dhe shërbime, përfshi dhe zyra	2 000	700	300
III. Ndërtesa të tjera	1 500	500	200



Aneksi 8

TAKSA VENDORE E FJETJES NË HOTEL SIPAS KATEGORIVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE (BASHKIVE)
Lekë për natë fjetje për person

KATEGORITË E NJËSIVE AKOMODUESE HOTELERIKE	KATEGORITË E BASHKIVE		
	I	II	III
	TIRANË DURRËS	VLORE FIER SARANDË POGRADEÇ KORÇË ELBASAN BERAT LUSHNJË GJIROKASTËR SHKODËR KAVAJË LEZHË	BASHKITË E TJERA Dhe të gjitha njësitë administrative jashtë qytetit përkatës për bashkitë e kategorive I, II dhe III, të cilat ju bashkuan njësitë të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit Nr. 115/2014
Hotel me 4 dhe 5 yje	350	175	105
Hotel nën 4 yje, motel, hostel, bujtinë, si dhe çdo njësi tjetër akomoduese të ngjashme me to, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	140	70	35

**LIGJ
Nr. 96/2018**
**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 92/2014, “PËR TATIMIN
MBI VLERËN E SHTUAR NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**
VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 49, “Shkallët e reduktuara”, pas pikës 5 shtohen pikat 6, 7 dhe 8 me këtë përmbajtje:

“6. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e shërbimit të reklamave nga media audiovizive, është 6 për qind.

7. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e mjeteve të transportit publik të licencuar të udhëtarëve me autobus me nëntë plus një vende ose më shumë, vetëm me motor elektrik, është 6 për qind deri në datën 31 dhjetor 2021. Nga data 1 janar 2022 shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar që aplikohet për këtë furnizim është 10 për qind.

8. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e librave të çdo lloji, është 6 për qind.”.

Neni 2

Në nenin 51, “Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm”, pas shkronjës “m” shtohen shkronjat “n”, “nj” dhe “o” me këtë përmbajtje:

“n) furnizimi i makinave bujqësore. Lista e makinave bujqësore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave;



nj) furnizimi i inuteve bujqësore, siç janë plehrat kimike, pesticidet, farat dhe fidanët, përveç hormoneve të klasifikuar në kodet 2937 të NKM-së. Lista e kategorive të inuteve bujqësore përcaktohet vendim të Këshillit të Ministrave;

o) furnizimi i shërbimeve veterinarë, me përjashtim të shërbimeve veterinarë për kafshët shtëpiake.”.

Neni 3

Në nenin 53, “Përjashtime për disa veprimtari të tjera”, në shkronjën “j” fjalët “dhe i librave”, “dhe nga media elektronike” hiqen.

Neni 4

Në nenin 56, “Përjashtime të veçanta në import”, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 41 shfuqizohet.

2. Pas pikës 41 shtohet pika 42 me këtë përmbajtje:

“42. Importimi i lëndëve të para që përdoren për prodhimin e barnave, me përjashtim të lëndëve me përdorim të dyfishtë, të kryera nga mbajtësit e autorizimit të prodhimit, sipas legjislacionit të fushës për barnat. Lista e lëndëve të para për prodhimin e barnave përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Në nenin 57, “Eksportet”, shkronja “ç” riformulohet si më poshtë:

“ç) furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t’u rieksportuar, nga personat e tatueshem të autorizuar dhe nënkontraktorët e tyre, mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor, për operacione nën regjimin e përpunimit aktiv.

Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm, për zbatimin e shkronjës “ç”.

Neni 6

Në nenin 64, “Veprime që lidhen me regjimet doganore e të tjera të ngjashme”, në shkronjën “ç”, pas fjalëve “nën regjimin e përpunimit aktiv” shtohen fjalët “nga mbajtësi i autorizimit dhe nënkontraktorët e tij”.

Neni 7

Në nenin 148, “Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor”, fjalët “20 për qind” zëvendësohen me fjalët “6 për qind”.

Neni 8

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miraturar në datën 3.12.2018

LIGJ
Nr. 97/2018

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 9920, DATË 19.5.2008,
“PËR PROCEDURAT TATIMORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, 113, pika 1, shkronja “ç”, 155 dhe 157, pika 3, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 40, “Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare”, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Një person fizik me të njëjtin numër të identifikimit personal regjistrohet vetëm një herë nga Qendra Kombëtare e Biznesit. Atij i lind e drejta të regjistrohet dhe të pajiset me një NIPT/NUIS të ri nga Qendra Kombëtare e Biznesit, vetëm mbas çregjistrimit të NIPT-it/NUIS-it ekzistues.”.

Neni 2

Në nenin 43, “Përditësimi i të dhënave të regjistrimit”, pas pikës 1/1 shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje:



“1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkon të regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.”.

Neni 3

Në nenin 44, “Kalimi në regjistrin pasiv”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, në fund të shkronjës “c”, shtohen fjalët “dhe paguan të gjitha detyrimet tatimore.”.

2. Pas pikës “4” shtohet pika “4/1” me këtë përmbajtje:

“4/1. Kalimi në regjistrin pasiv të tatimpaguesve persona fizikë dhe juridikë, nga Qendra Kombëtare e Biznesit, bëhet duke verifikuar më parë pagimin e detyrimeve tatimore nga ana e tyre. Verifikimi në administratën tatimore bëhet në rrugë elektronike brenda së njëjtës ditë pune.”.

3. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Administrata tatimore qendrore publikon në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe përditëson mbi baza ditore listën e tatimpaguesve që janë në regjistrin pasiv.

Çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit, persona fizikë apo juridikë, tregtarë, që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë:

a) për shitësin, i cili është në regjistrin pasiv, bëhet vlerësim tatimor dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji;

b) për blerësin, vlerësim tatimor për mosnjohjen e TVSH-së së zbritshme dhe të shpenzimit.

Gjithashtu, çdo transaksion i kryer nga tatimpaguesit aktivë, persona fizikë apo juridikë tregtarë, me tatimpaguesit që janë në regjistrin pasiv, konsiderohet shkelje administrative dhe dënohet si më poshtë:

c) shitësi aktiv, në përputhje me pikën 2, të nenit 128, të këtij ligji. Ky dënim nuk aplikohet në rastet kur, për arsye teknike, lista e tatimpaguesve në regjistrin pasiv nuk është përditësuar nga administrata tatimore;

ç) blerësi në regjistrin pasiv, me vlerësim tatimor të detyrimit dhe dënim, në përputhje me nenin 116 të këtij ligji.”.

Neni 4

Neni 45, “Çregjistrimi i subjekteve tatimore”, ndryshohet në titull dhe në përmbajtje si më poshtë:

“Neni 45

Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve

1. Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë regjistruar në administratën tatimore, sipas pikave 1 deri 4, të nenit 40, dhe të nenit 42, të këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i administratës tatimore vetëm pas çregjistrimit të tyre në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe/ose në gjykatë.

Subjektet/tatimpaguesit, të cilët janë të regjistruar në administratën tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, çregjistrohen nga drejtoritë rajonale tatimore, sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.

2. Data e çregjistrimit të tatimpaguesit në administratën tatimore është data e çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose në gjykatë, për të gjitha subjektet që çregjistrohen pranë tyre.

Data e çregjistrimit të personave juridikë publikë apo të ngjashme me to, si dhe të institucioneve e organizatave ndërkombëtare, është data e aktit/vendimit të mbylljes nga institucioni përkatës.

Datë e çregjistrimit për subjektet/tatimpaguesit e tjerë është data e miratimit të çregjistrimit të tyre nga administrata tatimore.

3. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve, që janë pjesë e regjistrit të Qendrës Kombëtare të Biznesit:

3.1 Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit nga regjistri i administratës tatimore fillon në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe, mbas çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, bëhet çregjistrimi në regjistrin e administratës tatimore.

3.2 Qendra Kombëtare e Biznesit, me marrjen e kërkesës për çregjistrim të personit fizik, njofton menjëherë organin tatimor në rrugë elektronike mbi datën e kërkesës për çregjistrimin e tij.

Për personat juridikë, Qendra Kombëtare e Biznesit njofton statusin e shoqërisë në likuidim, dhe në vijim, kur shoqëria dorëzon raportin përfundimtar të likuidimit, dërgon në organin tatimor datën e paraqitjes së këtij raporti.

Për personat juridikë, që kryejnë çregjistrimin nëpërmjet procedurave të bashkimit apo ndarjes së shoqërive, Qendra Kombëtare e Biznesit dërgon në organin tatimor përkatës vendimin përfundimtar



të miratimit të bashkimit/ndarjes së shoqërive.

3.3 Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim të personave fizikë, apo paraqitjes së raportit përfundimtar të likuidimit për personat juridikë, është e detyruar të verifikojë dhe të vlerësojë situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit në llogarinë e tij në kontabilitetin dhe sistemin e të dhënave që disponon. Për situatën tatimore të subjektit/tatimpaguesit, si dhe për deklaratat e padorëzuara nga ai, administrata tatimore njofton brenda këtyre 10 ditëve tatimpaguesin.

Kur administrata tatimore, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku kryen veprimtarinë subjekti, ky kontroll dhe pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit nuk mund të zgjasë më shumë se 30 ditë pune.

Komunikimi me Qendrën Kombëtare të Biznesit, për detyrimet tatimore dhe deklaratat e padorëzuara të tatimpaguesit, do të bëhet në rrugë elektronike, në kohë reale, sipas marrëveshjes dypalëshe dhe protokollit elektronik të komunikimit ndërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3.4 Qendra Kombëtare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit në kohë reale rezultojnë detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes. Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjekti, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (*e-mail*) ose dhe me shkresë zyrtare.

3.5 Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit/subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklarata të padorëzuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar menjëherë në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

4. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që likuidohen në gjykatë:

4.1 Gjykata, me marrjen e kërkesës për

çregjistrim prej subjektit/tatimpaguesit, njofton menjëherë organin tatimor kompetent për regjistrimin e hapjes së procedurave të likuidimit dhe në vijim për paraqitjen e raportit përfundimtar të likuidimit. Ky njoftim bëhet edhe për personat juridikë që likuidohen dhe çregjistrohen në gjykatë sipas dispozitave të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” apo subjekteve/tatimpaguesve që hyjnë në procedura falimentimi.

4.2 Administrata tatimore, brenda 10 ditëve pune nga data e paraqitjes së kërkesës për çregjistrim në gjykatë, është e detyruar të verifikojë situatën tatimore të subjekteve dhe njofton gjykatën dhe subjektin mbi këtë situatë. Kur organi tatimor, sipas analizës së riskut, gjykon se është e nevojshme të ushtrojë kontroll në mjedisin ku ushtron veprimtarinë subjekti, atëherë ky kontroll, pasqyrimi i tij në situatën e tatimpaguesit dhe njoftimi i gjykatës nuk mund të zgjasin më shumë se 30 ditë kalendarike.

4.3 Gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit të 30 ditëve administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin. Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumë e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe faktin që nuk ka dorëzuar deklarata tatimore apo nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit përfundimtar.

Nëse organi tatimor nuk i përgjigjet gjykatës brenda afatit 30-ditor, gjykata çregjiston subjektin/tatimpaguesin dhe njofton në të njëjtën ditë organin tatimor dhe tatimpaguesin.

4.4 Kur subjekti pagan detyrimet e papaguara në kohë, administrata tatimore njofton menjëherë gjykatën dhe vetë subjektin se ai nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Gjykata kryen çregjistrimin dhe dërgon në administratën tatimore dokumentin e çregjistrimit të subjektit, përfshirë datën e çregjistrimit.

5. Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve që regjistrohen vetëm në regjistrin e administratës tatimore, sipas pikës 4.1, të nenit 40, të ligjit, dhe që janë të regjistruara në drejtoritë rajonale tatimore me procedura të thjeshtuara, si: ambulantë, përfaqësues tatimorë, fermerë, individë etj., bëhet pranë drejtorive rajonale tatimore përkatëse, sipas procedurave të thjeshtuara të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat.



6. Subjektet e regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit/gjykatë dhe në administratën tatimore çregjistrohen nga regjistri elektronik pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore, përfshirë detyrimet që lindin në rastin kur çregjistrimi kryhet me likuidim. Në rastin e falimentit, subjekti/tatimpaguesi do të çregjistrohet sipas vendimit të gjykatës me statusin “i falimentuar”.

7. Nëse pavarësisht se detyrimi tatimor për të cilin është kundërshtuar çregjistrimi është shlyer, por administrata tatimore nuk e ka tërhequr kundërshtimin, subjekti/tatimpaguesi paraqet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit apo gjykatës dokumentin që vërteton shlyerjen e detyrimeve tatimore. Në këtë rast Qendra Kombëtare e Biznesit apo gjykata kryejnë menjëherë çregjistrimin dhe njoftojnë administratën tatimore dhe tatimpaguesin.

8. Çregjistrimi i subjektit/tatimpaguesit në Qendrën Kombëtare të Biznesit apo gjykatë nuk eliminon detyrimet tatimore të papaguara dhe nuk e ndalon administratën tatimore të vlerësojë ose të mbledhë me forcë detyrimet tatimore.”.

Neni 5

Në nenin 68, “Vlerësimi tatimor”, në pikën 8, fjalët “, me vlerë deri në 100 (një qind) lekë,” zëvendësohen me fjalët “, me vlerë deri në 1 000 (një mijë) lekë,”.

Neni 6

Në nenin 71, “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) tatimpaguesi me status “person fizik tregtar”, i cili, për qëllime të shmangies tatimore dhe minimizimit të detyrimit tatimor, regjistron/mban më tepër se një numër identifikimi unik të subjektit, dhe dorëzon deklarata të veçanta për çdo NIPT/NUIS.”.

Neni 7

Pas nenit 71/1 shtohet neni 71/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 71/2

Përdorimi i metodave alternative të vlerësimit në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor

1. Në rastet kur një apo disa tatimpagues kryejnë një veprim/transaksion apo seri veprimesh / transaksionesh direkte apo indirekte me persona të tretë, ku:

a) veprimet e ndërmarra nga tatimpaguesi deformojnë parimet e ligjit tatimor;

b) veprimet/transaksionet nuk bazohen në parimin e vlerës së tregut;

c) veprimet/transaksionet janë pa efekte ekonomike thelbësore;

ç) forma e veprimit/transaksionit nuk reflekton thelbin e tij ekonomik;

d) evidentohen elemente të veprimeve/transaksioneve që synojnë shmangien ose uljen e detyrimeve tatimore.

Për përcaktimin e detyrimit tatimor, administrata tatimore nuk merr parasysh një veprim/transaksion apo një seri veprimesh/transaksionesh, të cilat, duke qenë se janë ndërmarrë me synim përfitimin e një avantazhi tatimor që vjen në kundërshtim me qëllimin e ligjit, rezultojnë fiktive në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave.

2. Kur një veprim/transaksion apo seri veprimesh/transaksionesh janë në kushtet e pikës 1 më sipër, veprimi/transaksioni rikarakterizohet dhe detyrimi tatimor llogaritet në përputhje me dispozitat për vlerësimin tatimor alternativ të këtij ligji dhe ligjeve të tjera tatimore. Në këto raste, barrën e provës e ka kryesisht administrata tatimore.”.

Neni 8

Në nenin 75, “Detyrimet tatimore të paguara më tepër”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Kompensimi nga teprica kreditore i detyrimeve tatimore brenda çdo tatimi, me përjashtim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, kryhet automatikisht nga sistemi informatik.”.

Neni 9

Në nenin 79, “Radha e pagesës së kontributeve dhe të detyrimeve tatimore”, në krye të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:



“Pagesat e kryera për çdo tatim, përveç pagesave për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, fillimisht do të shkojnë për të mbyllur detyrimet më të hershme brenda të njëjtit lloj detyrimi, në qoftë se këto detyrime nuk janë në proces apelimi, gjykimi apo në marrëveshje të pagesës me këste të detyrimeve tatimore të papaguara.”.

Neni 10

Në nenin 89, “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kur administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, ajo i dërgon atij, me postë rekomande ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar detyrimet tatimore zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.”.

Neni 11

Në nenin 90, “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, në pikën 1, në fjalinë e parë, pas fjalëve “çdo banke,” shtohen fjalët “me postë rekomande ose në rrugë elektronike,”.

Neni 12

Në nenin 103, “Procedurat për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm dhe fshirja/shuarja e tij”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Pas deklarimit të pambledhshëm të detyrimit tatimor ose të një pjese të tij, organi tatimor evidenton në regjistrin kontabël detyrimet që janë deklaruar të pambledhshme në zbatim të ligjit.”.

2. Pas pikës 7 shtohen pikat 8 e 9 me këtë përmbajtje:

“8. Fillimi i procedurës për deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm mund të bëhet me kërkesë nga ana e tatimpaguesit ose kryesisht nga ana e organit tatimor.

9. Administrata tatimore publikon çdo vit vlerën totale të detyrimeve tatimore të deklaruara si të pambledhshme, numrin e kërkesave në total dhe numrin e kërkesave të pranuar.”.

Neni 13

Në nenin 107, “Pagesa e detyrimit tatimor, objekt ankimi”, në pikën 2, në fund të fjalisë shtohen fjalët “, si dhe kamatëvonesat e llogaritura.”.

Neni 14

Në nenin 115, “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Deklarim i pasaktë konsiderohet edhe rasti kur, si rezultat i një kontrolli tatimor, bëhet rivlerësim në ulje i tepricës kreditore të tatimpaguesit. Në këtë rast tatimpaguesi penalizohet me gjobë 20 % të diferencës ndërmjet tepricës kreditore të deklaruar me tepricën kreditore që duhej deklaruar.”.

Neni 15

Pas nenit 115/1 shtohet neni 115/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 115/2

Dënimet për mosnjoftimin e ndryshimeve në lidhje me ndryshimin e pronësisë

Nëse një person juridik nuk njofton administratën tatimore lidhur me ndryshimet e pronësisë, sipas kërkesave të nenit 27/1, “Ndryshimi i pronësisë”, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ai është përgjegjës dhe dënohet si më poshtë:

a) për shkeljen në rastin e pikës 3, të nenit të sipërpërmendur, 15 për qind të vlerës së tregut të aktiveve të trajtuara si me ndryshim pronësie;

b) për shkeljen në rastin e pikës 4, të nenit të sipërpërmendur, 5 për qind të vlerës së tregut të aksioneve ose interesave të ngjashëm që u ka ndryshuar pronësia.

Dënimi, sipas shkronjës “b” më sipër, nuk zbatohet kur vërtetohet që personi nuk ishte në dijeni të ndryshimit të pronësisë apo nuk ka të dhëna, prova apo fakte që të besohet se personi duhet të ishte në dijeni.”.

Neni 16

Në nenin 124, “Kundërvajtjet në lëshimin e faturave tatimore, dëftesave tatimore dhe dokumentimin e transaksioneve”, pas paragrafit të



pikës 1 shtohet paragrafi i dytë me këtë përmbajtje:

“Nëse tatimpaguesi pranon vlerësimin tatimor dhe e paguan detyrimin, gjoba, sipas paragrafit më lart të kësaj pike, zbritet me 30 për qind.”.

Neni 17

Në nenin 129, “Dënimet për tatimpaguesit, që janë banka apo institucione financiare”, në fund të shkronjës “ç” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në çdo rast, shumën e gjobës që zbatohet nuk mund të jetë më e madhe se shumën e kërkuar për t’u bllokuar.”.

Neni 18

Në nenin 135, “Nxjerrja e akteve nënligjore”, pasi pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat për nxjerrjen e aktit nënligjor në lidhje me procedurat dhe kriteret e zbatimit të nenit 71/2, lidhur me përdorimin e metodave alternative të vlerësimit, në rastet e veprimeve për shmangien e tatimit dhe abuzimit me parimet e ligjit tatimor.”.

Neni 19

Hyrja në fuqi

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2018

LIGJ Nr. 98/2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 61/2012, “PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR¹

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me Direktivën e Këshillit 2011/64/EU, datë 21 qershor 2011, “Mbi strukturën dhe normat e akcizës, që aplikohen për duhanin e prodhuar”. Numri CELEX: 32011L0064, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian Seria L, Nr. 176, 5 korrik 2011, faqe 24–36.

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 41, “Aplikimi i pullave fiskale”, pika 5, ndërmjet fjalëve “cigareve” dhe “poshtë” shtohen fjalët “dhe te duhani i grirë”.

Neni 2

Në nenin 78, “Përkufizime”, pas pikës 6 shtohet pika 7 me këtë përmbajtje:

“7. Duhan me ngrohje, klasifikuar me kodin 2403 90 90 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, cilësuar si produkte duhani të riformuara edhe me substanca të tjera, që konsumohet nga një proces ngrohjeje, nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani, të klasifikuar në kodin 8543 70 90, i cili lejon përdoruesin të thithë avujt nga duhani që gjendet në të.”.

Neni 3

Neni 80/1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 80/1

Importimi dhe prodhimi i letres së cigareve në formën e broshurave apo të tubave që përfshihen në kodin 4813 1000, të filtrit të cigares që përfshihet në kodin 4823 dhe 5601 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, kryhet vetëm nga subjektet grumbullues-përpunues të duhanit, të pajisur me linja me cikël të plotë përpunimi dhe paketimi për tregtim, të cilët disponojnë autorizim depozitues i miratuar magazine fiskale prodhimi.

Përveç kushteve të përgjithshme të pajisjes me autorizim magazinë fiskale prodhimi, sipas nenit 20, të ligjit, kushtet specifike, që duhet të përmbushin subjektet përcaktohen me udhëzim nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 4

Në nenin 86, “Penalitetet”, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:



“3. Penalitetet për të gjitha shkeljet e kryera në qarkullimin e pullave fiskale gjatë proceseve të porositjes dhe lëvizjes së tyre rregullohen nga ky kre.”.

Neni 5

Në nenin 88, “Prodhim klandestin i produkteve të akcizës”, pika 1, shkronja “a”, fjala “fiskale” zëvendësohet me fjalët “të akcizës”.

Neni 6

Në nenin 90, “Teprica ose mangësi në magazinën fiskale dhe në qarkullimin e produkteve që i nënshtrohen akcizës”, pika 6, shkronja “c”, fjalët “për tentativë për të shmangur produktin nga pagesa e akcizës” hiqen.

Neni 7

Pas nenit 94 shtohet neni 94/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 94/1

Shkeljet në qarkullimin e pullave fiskale

Tepricat ose mangësitë në pullat fiskale mbi 2 % të konstatuara gjatë kontrollit të operatorëve ekonomikë, në rastet kur nuk janë depozitues të miratuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe ndëshkohen me gjobë sa 3-fishi i detyrimeve të

akcizës, që duheshin paguar si për produktet e akcizës të konvertuara në sasitë përkatëse, me përjashtim të rasteve kur diferencat në qarkullimin e pullave fiskale të konstatuara gjatë procesit të lëvizjes, janë rrjedhojë e aksidenteve rrugore, hekurudhore, detare dhe ajrore apo nga forca natyrore të pakontrolluara, të cilat vërtetohen nga organet doganore, policore dhe të prokurorisë.”.

Neni 8

Në nenin 95, “Mbajtja, transportimi ose shitja e produkteve të akcizës pa shenjues ose ngjyruës”, shkronja “a”, fjala “fiskale” zëvendësohet me fjalët “të akcizës”.

Neni 9

Shtojca nr.1, “Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë”, bashkëlidhur ligjit, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 janar 2019.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.12.2018



SHTOJCA NR.1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
I KAFE			
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. Zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentre kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafë etj.)	250 lekë/kg kafe
II BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE			
B000 Birra	22 03	Birrë e bërë nga malto: -nga prodhues vendas e të huaj,	360 lekë/HL/ shkallë
		ligjërishit dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të vogël se 200 000 HL në vit:	alkoolometrike 710 lekë/HL/ shkallë
		Nga prodhues vendas e të huaj, ligjërishit dhe ekonomikisht të pavarur, me sasi më të madhe se 200 000 HL në vit	alkoolometrike
W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	-3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë -10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spumante, Shampanja dhe pije të	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa	5 200 lekë/HL



fermentuara dhe të gazuara	22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	“kërpudhë” që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak. Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara. Cider dhe cider dardhe me përmbajtje alkooli 8,5%	3120 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39 22 06 00 59 22 06 00 89	Pijet alkoolike të ndërmjetme me njëforcë alkooli mbi 15% volum por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5 200 lekë/HL
S200 Pije alkoolike (Spirituous Beverages)	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërësve të rrushit, Ëhisky, Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva, Vodka, likere dhe tonike, Uzo. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 20 000 hektolitër/vit	65 000 lekë për HL alkool anhidër



	22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049 22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010	- nga prodhues vendas e të huaj me sasi >20 000 hektolitër/vit	84 500 lekë për HL alkool anhidër
--	---	---	--------------------------------------

	22087090 22089011 22089019 22089033 22089038 22089041 22089045 22089048 22089052 22089054 22089056 22089069 22089071 22089075 22089077 22089078		
S300 Alkooli etilik jo i denatruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër
S400 Alkool etilik i denatruar	22072000	Alkool etilik i denatruar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2% ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
III DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ			
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan	6000lekë/kg
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan	5550 lekë/1000 fije Më 1 janar 2018 5850 lekë/1000 fije Më 1 janar 2019 6000 lekë/1000 fije Më 1 janar 2020 6250 lekë/1000 fije Më 1 janar 2021 6500 lekë/1000 fije
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	6000 lekë/kg



T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit, duhan i homogjenizuar ose i rindërtuar, ekstrakte dhe esenca prejduhani Duhan i përpunuar me gjethe duhanitë kultivuara në Shqipëri	6000 lekë/kg 2500 lekë/kg
T401 Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosje	38 24 99 56 38 24 99 57	Nikotinë lëng për mbushjen e cigareve elektronike, të përcaktuara në kode 85 43 70 90, të përdorura për krijimin e një procesi tymosje	10 lekë/ml të totalit të litrave brenda ambalazhit
T402 Duhan me ngrohje	24 03 90 90	Duhan me ngrohje, produkte duhani të riformuar dhe me substanca të tjera, që konsumohen nga një proces ngrohje nëpërmjet një aparati elektronik për ngrohje duhani	6000 lekë/kg

IV PRODUKTET ENERGJETIKE

E200 Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në kërret 1507 deri 1518 të NK nëse përdoren për ngrohje apo motorë	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve apo vegjetale dhe produktet prej tyre	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
---	----------------	--	--

E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95-98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguret Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndëdjegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra naftë	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg



E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg
E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpeninën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (psh asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E492	27 14 90 00	Zhavor bituminoz	0,3 lekë/kg
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh.	8 lekë/litri
E501 Gaze të naftës dhe Hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	0 lekë/litri
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (Alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg



L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti, kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore /Biodiezel me më pak se 70% vajra naftë të kapitullit 27	37 lekë/litri
V FISHEKZJARRËT			
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
VI GOMAT			
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg
P300 Goma të përdorura	40 12 20 00	Goma pneumatike të përdorura	100 lekë/kg
VII PILAT DHE BATERITË PRIMARE; AKUMULATORËT ELEKTRIKË			
A200 Akumulatorët	85 07	Akumulatorët elektrikë, përfshirë ndarëset e tyre, nëse janë apo jo drejtkëndëshe (përfshirë katrorët)	20 lekë/kg

VENDIM
Nr. 127/2018

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË
INSTITUTIT TË STATISTIKAVE
(INSTAT)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Institutit të Statistikave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:


- I. Struktura e INSTAT-it është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur.
- II. Organika e INSTAT-it është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.12.2018



Lidhja nr.1



Lidhja nr. 2

ORGANIKA E INSTITUTIT TË STATISTIKAVE

POZICIONI	KATEGORIA	NUMRI
I DREJTOR I PËRGJITHSHËM		1
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	I-b	1
SEKRETAR		1
II SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE I INTEGRIMIT EUROPIAN		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2



III	SEKTORI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
IV	DREJTORIA KOMUNIKIMIT DHE PUBLIKIMEVE		(8)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
	SEKTORI I PUBLIKIMEVE DHE MARKETINGUT		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
	BIBLIOTEKAR		(1)
V	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRODHIMIT STATISTIKOR		
	DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
V/1	DREJTORIA E LLOGARIVE KOMBËTARE		(19)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE VJETORE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I LLOGARIVE TË SEKTORËVE INSTITUCIONALË		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI SINTEZË I LLOGARIVE KOMBËTARE		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE QENDRORE DHE RAJONALE		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
V/2	DREJTORIA E STATISTIKAVE EKONOMIKE		(19)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I STATISTIKAVE STRUKTURE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I STATISTIKAVE AFATSHKURTRA		(6)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	5



	SEKTORI I REGJISTRIT STATISTIKOR TË NDËRMARRJEVE		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË R&D, INOVACIONIT, TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TRANSPORTIT		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
V/3	DREJTORIA E STATISTIKAVE SOCIALE		(18)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË POPULLSISË		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I ZHVILLIMIT TË STATISTIKAVE SOCIALE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË KONSUMIT TË FAMILJEVE		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I NIVELIT TË JETESËS		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
V/4	DREJTORIA E STATISTIKAVE TË BUJQËSISË DHE MJEDISIT		(15)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË TOKËS DHE PRODHIMIT BIMOR		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË BLEGTORISË DHE PESHKIMIT		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
	SEKTORI I LLOGARIVE EKONOMIKE NË BUJQËSI DHE MJEDIS		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST PËR INDEKSIN E ÇMIMEVE	III-b	3
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË MJEDISIT DHE PYJEVE		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
V/5	DREJTORIA E STATISTIKAVE TË SEKTORIT REAL		(17)
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I LLOGARIVE KOMBËTARE 3-MUJORE		(4)



	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I TREGTISË SË JASHTME		(3)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	2
	SEKTORI I ÇMIMEVE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I STATISTIKAVE TË TREGUT TË PUNËS		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
VI	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE		
	DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
VI/1	DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT		<u>(29)</u>
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I MENAXHIMIT TË BAZAVE TË TË DHËNAVE DHE AKSESIT NË MIKRODATA		(7)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	6
	SEKTORI I CILËSISË DHE METADATAVE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE KOMPJUTERIKE		(5)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	4
	SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË RRJETIT DHE SERVERAVE		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I METODOLOGJISË		(7)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	6
VI/2	DREJTORIA E STATISTIKAVE RAJONALE DHE GJEONFORMACIONIT		<u>(64)</u>
	DREJTOR	II-b	1
	SEKTORI I GJEONFORMACIONIT (GIS)		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
	SPECIALIST	III-b	3
	SEKTORI I KOORDINIMIT DHE MBLEDHJES SË TË DHËNAVE		(4)
	PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1



SPECIALIST	III-b	3
SEKTORI I PLANIFIKIMIT DHE MONITORIMIT TË MBLEDHJES SË TË DHËNAVE		(6)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	5
ZYRAT RAJONALE		(49)
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE TIRANË		4
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	3
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE ELBASAN		4
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KORÇË		6
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	5
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE SHKODËR		5
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE LEZHË		4
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DIBËR		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE DURRËS		4
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	3
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE VLORË		5
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	4
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE FIER		6
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	5



ZYRA RAJONALE STATISTIKORE KUKËS		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2

ZYRA RAJONALE STATISTIKORE BERAT		3
PËRGJEGJËS ZYRE	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	2
ZYRA RAJONALE STATISTIKORE GJIROKASTËR		2
PËRGJEGJËS	III-b	1
SPECIALIST	IV-b	1

**VII DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE
MBËSHETËSE DHE KOORDINIMIT**

DREJTOR I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME	II-a	1
--------------------------------------	------	---

VII/1 DREJTORIA E FINANCËS DHE PROJEKTEVE		(27)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I FINANCËS		(5)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST BUXHETI	III-b	1
SPECIALIST FINANCE	III-b	2
SPECIALIST PËR FINANCIMET E HUAJA	III-b	1
SEKTORI I PROKURIMEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	1
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I PROJEKTEVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SEKTORI I SHËRBIMEVE		(11)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a/1	1
PROTOKOLLIST		1
TEKNIK/MAGAZINIER		1
NËPUNËS INFORMACIONI		1
SHOFER		3
PASTRUES/SANITAR		2
TEKNIK MIRËMBAJTJEJE		1
ARKIVIST		1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SPECIALIST	IV-a	1



VII/2 DREJTORIA KOORDINIMIT DHE ÇËSHËTJEVE LIGJORE		(8)
DREJTOR	II-b	1
SEKTORI I KOORDINIMIT DHE PLANIFIKIMIT		
STRATEGJIK (PSZ-së)		(4)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
SPECIALIST	IV-a	1
SEKTORI I ÇËSHËTJEVE LIGJORE/ADMINISTRATIVE		(3)
PËRGJEGJËS SEKTORI	III-a	1
SPECIALIST	III-b	2
PUNONJËS GJITHSEJ		236

VENDIM
Nr. 128/2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 43/2017 “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE
ORGANIKËS TË AUTORITETIT
TË KONKURRENCËS”

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 9, pika 2, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Lidhja nr. 1 dhe lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 43/2017, “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”, të ndryshuar, ndryshohen sipas lidhjes nr. 1 dhe lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.12.2018

Lidhja nr.1

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS





Lidhja nr. 2

**ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS, SHOQËRUAR
ME KATEGORIZIMIN E PAGËS PËR ÇDO POZICION**

POZICIONI	NUMRI
I. KRYETAR	(1)
II. KOMISIONER	(4)
III. KABINETI	(3)
Drejtor kabineti	1
Këshilltar	1
Sekretar	1
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	(1)
V. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE PRODHUESE	(7)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	6
VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË TREGJEVE TË SHËRBIMIT/JOPRODHUESE	(7)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	6
VII. DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE	(7)
Drejtor II-b	1
Inspektor III-a	6
VIII. DREJTORIA JURIDIKE DHE E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE	(6)
Drejtor II-b	1
Inspektor për vlerësimin e legjislacionit III-a	3
Inspektor për procedurat e hetimit III-a	2
IX. DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE KOMUNIKIMIT	(5)
Drejtor II-b	1
Specialist III-b	4
X. DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE	(5)
Drejtor II-b	1
Specialist financë/buxhet III-b	1
Specialist protokoll/arkiv IV-a	1
Shofer Kl. IV (VKM nr. 717, datë 23.6.2009, i ndryshuar)	1
Punonjës pastrimi	1
Gjithsej:	(46)

**VENDIM
Nr. 134/2018****PËR MIRATIMIN E MANUALIT
TË MONITORIMIT VJETOR
DHE PERIODIK**

Në mbështetje të neneve 78, pika 1, dhe 80 të Kushtetutës, të neneve 18, 55, 102, 103, 120 dhe 121, të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjeve organike të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, si dhe vendimit nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik, i cili do të shërbejë për zbatimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, sipas lidhjes bashkëlidhur.

II. Institucionet e pavarura, institucionet qendrore të administratës shtetërore dhe Kuvendi bashkëpunojnë dhe referojnë në këtë manual gjatë ndjekjes dhe zbatimit të miratuar me vendimin nr. 49/2017 “Për krijimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”.

III. Ngarkohen organet e Kuvendit dhe shërbimet e Kuvendit për zbatimin e këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 20.12.2018

**MANUALI I MONITORIMIT VJETOR
DHE PERIODIK****HYRJE**

Ky manual rregullon dhe detajon mekanizmin e miratuar me vendimin nr. 49/2017 të Kuvendit “Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë”, si dhe parashikon mënyrën, afatet dhe përgjegjësitë për bashkërendimin me ekzekutivin të veprimtarisë monitoruese të Kuvendit si pjesë e kontrollit parlamentar.

**PJESA I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR
RAPORTIMIN E INSTITUCIONEVE
NË MONITORIM**

I. Raportimi vjetor në Kuvend, në funksion të shqyrtimit të veprimtarisë së institucionit dhe miratimit të rezolutës për vlerësimin e veprimtarisë

1. Rregulla procedurale

Institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj të veçantë, që këtu dhe më poshtë do të quhen “institucione në monitorim” e që i nënshtrohen detyrimit për raportim në Kuvendin e Shqipërisë, miratojnë dhe paraqesin raportin vjetor, sipas afateve të parashikuara në ligjet që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Në fillim të çdo viti, mundësisht brenda datës 15 janar, institucionet në monitorim referojnë afatin brenda të cilit ata besojnë se do të jetë miratuar raporti vjetor. Ky parashikim është i nevojshëm për t’i bërë me dije Kuvendit rrethana apo kushte të caktuara, për shkak të të cilave institucioni mund të ndodhet ose rezultojë në vonesë në lidhje me afatin e parashikuar nga ligji për miratimin e raportit vjetor.

Pas shqyrtimit të informacioneve të mbërritura nga institucionet në monitorim, Kryetari i Kuvendit, në përputhje me nenin 103 të Rregullores së Kuvendit, i përcjell Konferencës së Kryetarëve kalendarin e fillimit të procedurave parlamentare të shqyrtimit në komisione dhe miratimit në seancë plenare të projektrezolutës për secilin institucion në monitorim, duke referuar tek afatet që ligji i posaçëm ka parashikuar për detyrimin për raportim.



Kalendari i miratuar publikohet dhe i bëhet me dije të gjitha institucioneve nëpërmjet Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit.

Pas njoftimit në Kuvend të kalendarit të miratuar në Konferencën e Kryetarëve, komisionet e përhershme parlamentare hartojnë kalendarët përkatës për institucionet në monitorim, sipas fushës së përgjegjësisë.

Brenda dy javëve nga depozitimi në Kuvend të raportit vjetor, komisioni i përhershëm parlamentar, që ka kompetencën për shqyrtim dhe përgatitje të projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë, organizon seanca dëgjimore të veprimtarisë nga titullari dhe përfaqësues të tjerë të institucionit në monitorim.

Në seancën dëgjimore të organizuar me komisionin përgjegjës, fjala prezantuese e përfaqësuesit të institucionit, duhet të jetë një përmbledhje që nuk mund të zgjasë më shumë se 20 minuta.

Bashkëlidhur këtij vendimi janë:

- formati i raportit të Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit me analizën e monitorimit të veprimtarisë së institucionit në monitorim;

- formati i raportit të komisionit parlamentar, për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në monitorim;

- formati i rezolutës që miratohet në komision dhe i përcillet seancës plenare.

2. Dokumentet që shoqërojnë raportin vjetor të institucionit në monitorim

Për qëllim të shqyrtimit të veprimtarisë së çdo institucioni në monitorim, të hartimit të raportit të komisionit për vlerësimin e veprimtarisë, projektrezolutës bashkëlidhur raportit të komisionit të përhershëm parlamentar, që i përcillet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare dhe, në funksion të identifikimit të të dhënave dhe informacioneve të posaçme që janë pjesë e hartimit të raporteve përmbledhëse ose statistikave nga Kuvendi, institucioni në monitorim, bashkë me raportin vjetor i përcjell në rrugë elektronike Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit edhe:

- a) një raport përmbledhës (jo më shumë se 6 faqe), në të cilin të përshkruhet në tërësi raporti dhe jep një pasqyrim të përgjithshëm të punës së institucionit, ecurisë dhe synimeve për të ardhmen, duke detajuar objektivat që ka

institucioni për vitin pasardhës, si dhe një parashikim në terma afatmesëm, deri në 3-vjeçare, në lidhje me vizionin e institucionit;

- b) materiale shpjeguese ose sqarime për çështje të caktuara që nevojiten të detajohen gjatë fazës së hartimit të raportit të monitorimit, raportit të komisionit parlamentar apo projektrezolutës.

3. Çështje që duhet të përfshihen në përmbajtjen e raportit vjetor të institucionit në monitorim

Institucioni në monitorim duhet të kujdeset që, edhe në rastet kur ligji i posaçëm ka identifikuar listë të çështjeve që duhet të përmbajë raporti vjetor, të referojë në çdo rast në raport edhe:

- a) mesazhin e titullarit të institucionit, apo organit drejtues në rastin e organeve kolegjiale;

- b) referencat në ligjin/ligjet mbi të cilat mbështetet veprimtaria e institucionit në monitorim;

- c) gjendjen ose nivelin e respektimit apo plotësimit nga institucioni në monitorim të detyrimeve ndërkombëtare, nëse ka të tilla, dhe nëse nuk ka të bëhet deklarimi i qartë për mungesën e këtyre detyrimeve;

- ç) pikë të posaçme shpjegimesh për rekomandimet e “Progresraportit të BE-së për Shqipërinë” dhe shkallën e përmbushjes së këtyre rekomandimeve nga institucioni në monitorim, nëse progresraporti ka rekomandime që duhen plotësuar prej institucionit;

- d) sqarim i detajuar për nivelin e zbatimit të rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë, duke listuar aktet e miratuara apo veprimet institucionale të ndërmarra;

- dh) ndryshimet që i janë bërë kuadrit rregullator në vitin për të cilin hartohet raporti dhe efekti që kanë sjellë (nëse ka pasur të tilla);

- e) në rastin e organeve kolegjiale të institucioneve që ndjekin qëllime mbikëqyrje tregjesh ose operatorësh, vendimarrjen gjatë vitit për të cilin raportohet dhe problematikat e hasura e që kanë nxitur nevojën për atë vendimarrje;

- ë) në rastet kur ligji ka parashikuar tagrin për kryerje inspektimesh ose hetimesh administrative, të dhëna lidhur me aktivitetin institucional në fushën që mbulon, të gjeneruara me sistem statistikash në raport me vitet e fundit



e në çdo rast duke u krahasuar së paku me vitin e mëparshëm;

f) vlerësimin për nivelin e zbatimit të detyrimeve ligjore nga vetë institucioni në monitorim dhe përgjegjësitë në rastet kur ligji është shkelur apo nuk është konsideruar;

g) statusin e zbatimit të rekomandimeve që institucione të tjera kushtetuese ose të pavarura kanë dhënë për institucionin në monitorim, duke trajtuar në mënyrë të veçantë raportet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, nëse ka;

gj) listë të përmbledhur të rekomandimeve të lëshuara nga institucioni në monitorim për institucione të tjera, si dhe të dhëna për institucionet që refuzojnë zbatimin e rekomandimeve;

h) nevojën për ndryshime në kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit ose në përgjithësi në ligje, akte nënligjore apo dispozita që janë detyruese për institucionin në monitorim;

i) organizimin e brendshëm të institucionit, duke përfshirë strukturën dhe organigramën;

j) të dhëna për të ardhurat dhe shpenzimet, përfshirë fondet e përfituara nga donatorë nëse ka pasur;

k) listë të kallëzimeve penale dhe proceset gjyqësore në vijim, nëse ka;

4. Raportimi i Bankës së Shqipërisë në Kuvend

Përveç sa parashikohet për të gjitha institucionet në monitorim, formati i raporteve që hartohen, miratohen dhe më pas përcillen në Kuvend nga Banka e Shqipërisë, për sa i takon përmbajtjes së raportit vjetor, duhet të mbajë në konsideratë edhe:

a) trajtimin e problemeve në masën e duhur në funksion të transparencës dhe duke referuar te shembuj nga autoritete mbikëqyrëse bankare të vendeve të Evropës;

b) përcjelljen e informacionit me gjuhë të qartë, duke synuar sqarimin e çdo problematike;

Për raportimin vjetor të Bankës së Shqipërisë duhet mbajtur në konsideratë fakti që BSH-ja ka një raport specifik me Kuvendin, për shkak se auditimi i Bankës së Shqipërisë bëhet në nivel profesional dhe të vazhdueshëm nga Inspektori i Përgjithshëm, i emëruar me vendim Kuvendi, dhe në praktikë ka rritur kompetencat si rrjedhojë e zhvillimeve, kryesisht pas krizës ekonomike.

Për këto arsye, faza e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë duhet të përfshijë trajtimin si pikë më vete, të identifikuara qartë, çdo grup problemesh madhore që trajton BSH-në, të grupuara përafërsisht si në vijim:

a) Analizat e zhvillimeve ekonomike në vend, (ligji parashikon që BSH-ja duhet të analizojë në raport të veçantë zhvillimet ekonomike dhe të prodhojë çdo tre muaj një raport të tillë), si pikë me vete.

b) Analizat e zhvillimeve në çmimet e konsumit, inflacion dhe zhvillimet monetare, (sipas ligjit prodhohet çdo gjashtë muaj një raport i posaçëm për zhvillimet monetare).

c) Stabiliteti financiar, (sipas ligjit, BSH-ja nuk ka objektiva të drejtpërdrejta për stabilitetin financiar. Megjithatë këtë funksion BSH e ka zhvilluar si rrjedhojë e detyrave që lindën për bankat qendrore pas krizës së vitit 2008). Deklaratat 6-mujore të stabilitetit financiar bëhen pjesë e vlerësimit vjetor të veprimtarisë, duke u bashkuar dy për gjashtëmujorët më të fundit. Nëse komisioni përgjegjës e vendos, në këtë raportim mund të ftohet GKSF (Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar, që parashikohet në ligjin për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare e që përbëhet nga Ministri i Financave + Guvernatori i Bankës së Shqipërisë + Kryetari i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare);

ç) mbikëqyrja bankare, (sipas ligjit, BSH-ja ka detyra të qarta për mbikëqyrjen e bankave dhe për shkak të veçantisë së sektori bankar komisioni përgjegjës mund të vendosë të kërkojë raport dhe seancë të dedikuara për këtë aktivitet, duke parë mundësinë që raportimi për mbikëqyrjen bankare të kombinohet me raportimin për stabilitetin financiar).

d) Aktiviteti i BSH-së (sipas ligjit BSH-ja duhet të raportojë në Kuvend për aktivitetin e vet që lidhet me buxhetin; investimet; emisionin e parasë; zhvillimin e aftësive të personelit; strukturat; zbatimin e standardeve të transparencës etj. Kësaj pjese të raportit vjetor i bashkëlidhet opinioni i përgatitur nga Inspektori i Përgjithshëm).

Gjatë hartimit të raporti vjetor, Banka e Shqipërisë duhet të mbajë parasysh që qëllimi i hartimit të një raporti vjetor është, midis të tjerash, përcjellja e mesazhit/mesazheve për



publikun, tregun dhe operatorët në treg. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë duhet orientohet drejt përdorimit të një gjuhe mjaftueshëm të kuptueshme. Në rast se kjo është e pamundur të bëhet në raportin teknik, atëherë në Kuvend dërgohet edhe një raport tjetër, i cili, në funksion të transparencës, duhet të trajtojë informacionin në gjuhë të thjeshtë, të qartë, të mjaftueshme dhe të kuptueshme nga perspektiva e lexuesit, për të bërë të mundur që mesazhi/mesazhet të përcillen me efektivitet.

5. Rregulla të posaçme për kategori të veçanta institucionesh të pavarura

Institucionet e pavarura, që për shkak të veprimtarisë së tyre specifike, ushtrojnë kompetenca kontrolli në të gjitha institucionet qendrore, të vartësisë ose institucione të tjera të pavarura apo edhe kushtetuese, vlerësohet se kanë rol të posaçëm në identifikimin e problematikave në funksion të mekanizmit të monitorimit, (p.sh.: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Avokati i Popullit etj.). Këto institucione, përveç raporteve vjetore, duhet të përcjellin në Kuvend edhe:

a) raporte përmbledhëse çdo gjashtë muaj për gjetjet e tyre dhe

b) rast pas rasti, raportime të veçanta për çështje që i vlerësojnë si të një rëndësie të madhe.

Titullarët e këtyre institucioneve janë përgjegjës për përcjelljen e informacioneve dhe për zbatimin e detyrimit sipas kësaj pike.

II. Informimi periodik, rast pas rasti dhe mbështetja buxhetore në Kuvend

1. Informimi periodik

Institucioni në monitorim, menjëherë pas miratimit të rezolutës së Kuvendit, harton dhe vë në funksionim një kalendar masash dhe personat e ngarkuar brenda institucionit për fillimin e zbatimit dhe ndjekjen e plotësimit të rekomandimeve të Kuvendit. Institucioni në monitorim gjatë vitit i përcjell:

a) çdo katër muaj pas miratimit të rezolutës, Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, informacione shpjeguese për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit, duke detajuar masat e marra, projektaktet në proces ose akte të miratuara dhe vendimmarrje, në lidhje me çdo pikë të rezolutës. Ky informacion është i nevojshëm me qëllim përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e përmbledhjeve gjashtëmujore nga Shërbimi i Monitorimit;

b) brenda muajit dhjetor dërgohet zyrtarisht informacioni i plotë dhe përfundimtar për nivelin e zbatimit të rekomandimeve me shpjegimet si në shkronjën “a” të kësaj pike;

c) çdo katër muaj, Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, material informues për rekomandime të dhëna për institucione të tjera, në rastet kur institucioni në monitorim, ka tagrin ligjor për dhënien e rekomandimeve. Ky informacion është i nevojshëm me qëllim përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e përmbledhjeve gjashtëmujore nga Shërbimi i Monitorimit;

ç) raporte periodike në komisionin përgjegjës për çështje të caktuara, siç mund të parashikohet rast pas rasti nga raporti i komisionit, nga rezoluta e Kuvendit ose nga vendime të komisionit përgjegjës.

2. Informimi rast pas rasti

Informimi rast pas rasti ka lidhje me:

a) raportime për zbatimin e rezolutës së Kuvendit, sipas parashikimeve të këtij manuali dhe sa herë që kërkohet nga Kuvendi;

b) kërkesa për informim për çështje të veçanta që konstatohen gjatë vitit.

3. Kërkesat për mbështetje buxhetore

a) Kërkesat për ndryshim në strukturë dhe organikë të institucioneve në monitorim e që nuk kërkojnë mbështetje buxhetore bëhen përgjithësisht në periudha kur në kalendarin e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare është shqyrtimi për miratimin e projektbuxhetit për vitin në vijim ose gjatë ndryshimeve në buxhet.

b) Kërkesa të tjera, që kërkojnë mbështetje buxhetore, bëhen vetëm në kuadër të miratimit të projektbuxhetit të vitit pasues, i përcillen Kuvendit të paktën dy javë përpara datës së parashikuar në kalendarin e shqyrtimit të projektbuxhetit. Ky kalendar i përcillet institucioneve në monitorim menjëherë pas miratimit. Pasi marrin dijeni për kalendarin, institucionet në monitorim depozitojnë buxhetin faktik 9-mujor.

c) Kur kërkesat për mbështetje buxhetore dërgohen në periudha të tjera të vitit, institucioni në monitorim duhet të mbajë në konsideratë që ajo kërkesë në çdo rast do të mund të shqyrtohet vetëm kur në kalendarin e Kuvendit dhe të komisioneve parlamentare do të jetë shqyrtimi i projektakteve për miratimin e buxhetit të shtetit ose ndryshimeve në buxhet.



Në çdo rast kërkesa duhet të përmbajné të dhëna për:

- a) bazën ligjore mbi të cilën mbështetet kërkesa për ndryshime strukturore;
- b) analizë të shkaqeve dhe nevojave për ndryshime strukturë;
- c) impakti që pritet të kenë ndryshimet në strukturë në veprimtarinë e institucionit;
- ç) kostot buxhetore të ndryshimeve strukturore.

Kërkesës duhet t'i bashkëlidhet komunikimi i plotë, i bërë paraprakisht me Ministrinë e Financave dhe Departamentin e Administratës Publike.

PJESA II RREGULLA PËR TITULLARËT E INSTITUCIONEVE QENDRORE TË ADMINISTRATËS SHETËTËRORE QË KANË FUNKSIONE KOORDINUESE DHE RAPORTUESE NDAJ KUVENDIT

I. Përgjegjësitë e ministrit të ngarkuar me marrëdhëniet me Kuvendin

Në funksion të analizës dhe përpunimit të të dhënave të lidhura me procesin e monitorimit, si pjesë e veprimtarisë së kontrollit parlamentar, komisionet parlamentare, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe shërbimet e Kuvendit, sipas rastit, presin dhe/ose koordinojné raporte që i vihen në dispozicion Kuvendit nga institucione qendrore të administratës shetëtare.

Ministri për marrëdhëniet me Kuvendin, të paktën një herë në vit, harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave për shqyrtim dhe miratim një projektakt për statusin e zbatimit të rekomandimeve që institucione të pavarura, kanë dhënë për institucione qendrore të administratës publike.

Një herë në gjashtë muaj, ministri përgjegjës për marrëdhëniet me Kuvendin i dërgon Kryetarit të Kuvendit informacion të detajuar si më poshtë:

- në lidhje me gjetjet e KLSH-së gjatë auditimeve të kryera nga KLSH në institucionet qendrore dhe ato të vartësisë të administratës publike.

Ky raportim duhet të përmbajë gjithashtu të dhëna për statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH, (të grupuara sipas

institucionit ku është kryer auditimi) dhe për arsyet e refuzimit të zbatimit të rekomandimeve. Të dhënat e dërguara përpunohen nga Shërbimi i Monitorimit dhe bëhen pjesë e trajtimit gjatë seancave të raportimeve me KLSH-në dhe, në rastet kur vlerësohet nga komisionet parlamentare përgjegjëse, bëhen objekt i trajtimit gjatë seancave dëgjimore ose të tjera, ku thirren të marrin pjesë institucione qendrore apo varësie ose titullarë institucionesh qendrore të administratës publike:

- në lidhje me gjendjen e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit;
- në lidhje me gjendjen e zbatimit të rekomandimeve që institucione të tjera pavarura kanë dhënë për institucione qendrore të administratës publike.

Ministri përgjegjës për marrëdhëniet me Kuvendin, nëse kërkohet, mund të thirret nga komisionet parlamentare, në seanca të posaçme ku trajtohen informacionet e detajuara, sipas parashikimeve të kësaj pjesë.

II. Detyrimi i institucioneve të veçanta të administratës qendrore për raportim në Kuvend

Ligje të veçanta kanë parashikuar detyrimin që, për shkak të rëndësisë të veprimtarisë ose të një veprimtarie specifike, institucionet e administratës qendrore të raportojné në Kuvend.

Seancat e raportimeve për këto institucione, në komisionet parlamentare, organizohen sipas së njëjtës procedurë me raportimin për institucionet e pavarura dhe ato kushtetuese.

Komisioni parlamentar përgjegjës është ai i parashikuar nga ligji dhe në rast se ligji nuk e parashikon, caktohet nga Konferenca e Kryetarëve, në përputhje me veprimtarinë e institucionit raportues dhe lëndës që trajtohet nga raporti.

Shërbimi i Monitorimit përgatit listën e institucioneve të veçanta të administratës publike, që për shkak të rëndësisë të veprimtarisë apo të një veprimtarie specifike, detyrohen nga ligji i posaçëm që të raportojné në Kuvend dhe kjo listë bëhet pjesë e kalendarit të raportimeve vjetore, ose e kalendarit të komisionit përkatës për kontrollin parlamentar.

Komisioni parlamentar përgjegjës, organizon seancat dhe përgatit në çdo rast një raport për çështjet e trajtuara dhe propozimet për zgjidhje.



Nëse komisioni parlamentar vendos, raporti i përcillet për shqyrtim dhe miratim seancës plenare, i shoqëruar me projektrezolutën përkatëse.

Nëse komisioni parlamentar vendos që nuk është e nevojshme që raporti t'i përcillet seancës plenare, në çdo rast e publikon atë dhe vë në dijeni Kryetarin e Kuvendit, i cili e njofton në seancën plenare më të parë.

PJESA III

RREGULLA PËR ORGANET E KUVENDIT QË JANË OSE BËHEN PJESË E PROCESIT TË MONITORIMIT DHE RAPORTI I TYRE ME SHËRBIMET E KUVENDIT

I. Niveli i komunikimit të institucionit në monitorim me titullarët dhe shërbimet e Kuvendit

Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit është zyrtari që mban komunikimin shkresor me institucionin në monitorim, për sa i takon:

a) përcjelljes së dokumentave të miratuara nga Kuvendi dhe për Kuvendin;

b) kërkesave të veçanta që i bëhen institucionit në monitorim nga organe ose deputetë të Kuvendit;

c) nënshkrimin e shkresave të nevojshme për procese dhe procedura të lidhura me monitorimin vjetor dhe të vazhdueshëm;

ç) të tjera, për të cilat nuk është parashikuar ndryshe në këtë akt.

Për mbajtjen e raporteve dhe komunikimeve në rrugë elektronike me Kuvendin, çdo institucion në monitorim cakton një person kontakti, i cili është përgjegjës për pritjen e çdo komunikimi në rrugë elektronike dhe përcjelljen e tij te personi/personat përgjegjës, brenda institucionit në monitorim.

Drejtuesi i Shërbimit të Monitorimit është përgjegjës për komunikime në rrugë elektronike, për:

a) kërkesa ose kujtesa që u dërgohen njëkohësisht të gjitha institucioneve në monitorim;

b) kërkesa për materiale shpjeguese ose sqarime për çështje të caktuara që nevojiten të detajohen gjatë fazës së hartimit të raportit të monitorimit, raportit të komisionit parlamentar, ose projektrezolutës;

c) komunikime të tjera të referuara për ndjekje nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Këshilltari i Shërbimit të Monitorimit është përgjegjës për komunikime në rrugë elektronike, për:

a) kërkesa që i drejtohen vetëm njërit prej institucioneve në monitorim, që ndiqen prej tij në përputhje me rregulloren e brendshme administrative;

b) kujtesa për respektimin e afateve të raportimit në lidhje me nivelin e zbatimit të rezolutës së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë për institucionet në monitorim që ndiqen prej tij;

c) kujtesa për përcjelljen e raporteve periodike në komisionin përgjegjës për çështje të caktuara, siç parashikohet rast pas rasti nga raporti i komisionit, nga rezoluta e Kuvendit ose nga vendime të komisionit përgjegjës;

ç) të tjera, të referuara për ndjekje nga Sekretari i Përgjithshëm ose Drejtuesi i Shërbimit të Monitorimit.

Çdo komunikim në rrugë elektronike bëhet me personin e kontaktit, të njoftuar më parë nga institucioni në monitorim.

II. Raportet e drejtuesit dhe/ose këshilltarit të Shërbimit të Monitorimit me komisionet parlamentare

Kryetari i komisionit parlamentar, ku bëhet raportimi vjetor dhe rast pas rasti i institucionit në monitorim, në bashkëpunim me drejtuesin e Shërbimit të Monitorimit dhe/ose këshilltarin e ngarkuar me ndjekjen e institucionit në monitorim, këshillohen për këndin kryesor, mbi të cilin duhet të fokusohet raporti i monitorimit vjetor të veprimtarisë së institucionit në monitorim.

Dokumentacioni që shqyrtohet gjatë hartimit të raportit të monitorimit vjetor të institucionit në monitorim, burimi/burimet e mbledhjes së informacionit, përmbajtja dhe mënyra e përditësimit të formateve për çdo institucion në monitorim parashikohen në rregulloren e brendshme e organizimit të shërbimeve të Kuvendit.

Në fillim të çdo viti, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit harton dhe shpërndan një formular për kryetarët e komisioneve parlamentare, me qëllim marrjen e një vlerësimi për performancën e shërbimeve të Kuvendit që angazhohen në procedura të kontrollit parlamentar, si dhe për nevojat për përmirësim të procedurave të brendshme.



PJESA IV
RREGULLA PËR PËRGATTJEN E
PËRMBLEDHJEVE DHE RAPORTEVE
VJETORE NGA KUVENDI

I. Kalendar i shqyrtimit të zbatueshmërisë së ligjeve

Kryetarët e komisioneve parlamentare, brenda 1 muaji nga fillimi i sesionit parlamentar, hartojnë dhe miratojnë një kalendar të koordinuar për çështje që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve ose paketave ligjore të caktuara, sipas fushës së përgjegjësisë të komisioneve parlamentare.

Kalendar mund të përfshijë si shqyrtimin dhe analizimin e ligjeve ose paketave ligjore që rregullojnë fusha të posaçme, ashtu edhe ligje që kanë dalë për miratimin e marrëveshjeve, në veçanti atyre që kanë ndikim financiar apo social.

Në funksion të hartimit të kalendarit të sesionit të ardhshëm, Shërbimi Juridik dhe Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit dorëzojnë bashkërisht, pranë secilit prej kryetarëve të komisioneve të përhershme parlamentare, propozimet për çështjet që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve ose paketave ligjore të caktuara e që vlerësohen prej tyre se duhet të trajtohen nga komisionet parlamentare në seanca të posaçme.

Kalendar miratohet nga Konferenca e Kryetarëve, brenda 2 muajve nga fillimi i çdo sesioni parlamentar.

Raportet e miratuara nga komisionet e përhershme parlamentare, pas shqyrtimit të çështjeve të trajtuara e që kanë lidhje me nivelin e zbatueshmërisë së ligjeve, në çdo rast publikohen në faqen zyrtare të Kuvendit.

Me vendim të komisionit të përhershëm parlamentar, çështja mund të përcillet për trajtim në seancë plenare, sipas dispozitave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit për përcaktimin e rendit të ditës së seancës plenare të Kuvendit. Në këtë rast komisioni i përcjell seancës edhe projektrezolutën përkatëse me rekomandimet për institucionet përgjegjëse.

Në çdo rast, kur raporti i miratuar në komisionet parlamentare nuk i përcillet seancës plenare, Kryetari i Kuvendit bën njoftimin publik për raportin e miratuar nga komisioni në seancën plenare më të parë.

II. Raporti i nivelit të zbatueshmërisë së rekomandimeve të Kuvendit

Pas përfundimit të të gjitha raportimeve nga institucionet në monitorim, Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit përgatit projektraportin “Për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit”. Vlerësimi bëhet për vitin përkatës, sipas konkluzioneve që kanë dalë nga shqyrtimi i veprimtarive të institucioneve në monitorim.

Raporti shqyrtohet dhe miratohet nga Byroja e Kuvendit, i njoftohet seancës plenare dhe bëhet publik.

III. Miratimi i Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes

Institucionet në monitorim, që nuk janë pjesë e sistemit të drejtësisë, miratojnë Kodin Etik dhe Rregullat e Sjelljes, të cilat duhet të mbajnë në konsideratë dhe të rregullojnë, midis të tjerave, etikën e funksionarit publik të emëruar nga Kuvendi dhe normat e përfaqësimit të institucionit prej tyre të të tretët dhe ndaj publikut. Për çdo individ që merr një emërim nga Kuvendi duhet të jetë e qartë që me vullnet të lirë po merr përsipër një funksion publik. Ndaj, pas kësaj, e gjithë sjellja dhe veprimtaria e tij duhet të ridimensionohet, duke u përshtatur me funksionin publik dhe me qëllim që të sigurohet dhe të mos cenohet paanësia në ushtrimin e funksionit individual nga njëra anë dhe funksionit të institucionit nga ana tjetër.

Raportet e vlerësimit vjetor të veprimtarisë, të hartuara dhe të miratuara nga komisionet parlamentare dhe Kuvendi, duhet të përmbajnë si pikë më vete analizën e zbatimit të Kodit Etik dhe Rregullave të Sjelljes nga ana e funksionarëve publikë të emëruar si titullarë të institucioneve në monitorim ose si anëtarë të bordeve apo këshillave mbikëqyrës të institucioneve në monitorim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR _____

Dokument Parlamentar

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ . ____ . ____

RAPORT
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË _____
PËR VITIN _____

Raporti duhet të referojë pa u kufizuar në:

1. Sqarim të përgjithshëm të përmbledhur të seancës/seancave, çështjeve të trajtuara dhe problematikës/problematikave kryesore.
2. Vlerësimin e zbatimit të rezolutës së vitit të kaluar.
3. Vlerësimin e performancës së institucionit.
4. Vlerësimin e zbatimit të Kodit Etik dhe të Sjelljes nga zyrtarët e emëruar nga Kuvendi.
5. Mënyrën e votimit dhe qëndrimin e pakicës nëse ka.

Dokumenti nënshkruhet nga:

- Deputeti relator dhe
- Kryetari i Komisionit të Përhershëm Parlamentar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
SHËRBIMI I MONITORIMIT TË INSTITUCIONEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____._____

Lënda: Raporti i Shërbimit të Monitorimit të Institucioneve për veprimtarinë e
_____ për vitin _____

Zotit _____

Kryetar i Komisionit _____

Për dijeni: Zotit _____

Kryetar i Kuvendit

Çështjet që duhet të trajtojë Raporti i Shërbimit të Monitorimit (pa u kufizuar):

1. Referencat ligjore të nevojshme për analizimin e veprimtarisë.
2. Problematika të dala nga Monitorimi Vjetor dhe Periodik.
3. Vlerësimi i Shërbimit të Monitorimit për shkaqet dhe analiza profesionale e rastit/rasteve, përfshirë propozimet për zgjidhjen.
4. Vlerësimi për plotësimin e rezolutës së Kuvendit.
5. Vlerësimi i performancës së institucionit nga këndvështrimi i Shërbimit të Monitorimit.
6. Vlerësimi i raportit vjetor të institucionit.
7. Propozime për ndryshime apo përmirësime ligjore nëse dalin nga analiza e performancës dhe shqyrtimi i raportit vjetor të institucionit.
8. Vlerësimi i Kodit Etik dhe të Sjelljes dhe niveli i zbatimit të Kodit të Sjelljes dhe Etikës nga titullarët ose anëtarët e bordeve të emëruar nga Kuvendi.
9. Të tjera në varësi të tipologjisë së institucionit.

**Raporti nënshkruhet nga këshilltari përgjegjës i Shërbimit të Monitorimit
Drejtuesi i Shërbimit dhe
Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit**

**PROJEKTREZOLUTË**

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË _____
PËR VITIN _____

Kuvendi i Shqipërisë:

- Shpjegim i fokusit të institucionit gjatë vitit për të cilin bëhet vlerësimi i veprimtarisë.

Ka marrë në shqyrtim veprimtarinë e _____

- Citim i çështjeve kryesore të dala nga vlerësimi i veprimtarisë; dhe
- Vlerësimi i performancës së institucionit gjatë vitit të kaluar.

Kërkon që _____, për vitin _____ të angazhohet në këto drejtime:

- Listë të rekomandimeve të Kuvendit për tu zbatuar ose plotësuar gjatë vitit në vazhdim.

VENDIM
Nr. 137/2018

PËR MOSMIRATIMIN E
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8417,
DATË 21.10.1998, “KUSHTETUTA
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 177 të Kushtetutës dhe të neneve 38, pika 6, 77/a dhe 77/b të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 21.12.2018

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 308 lekë